



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 23/2, DATË 20/11/ 2017

PËR PLOTËSIM TË MËTEJSHËM DOKUMENTACIONI LIDHUR ME KËRKESËN PËR PËRFITIM TË STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “DELTA BAY”

Në mbështetje të Nenit 9 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë” dhe Kreut II, pika 8 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015, Komiteti i Investimeve Strategjike,

VENDOSI:

1. Plotësim i mëtejshëm me dokumentacion shtesë mbi kërkesën për përfshirjen e projektit investues “Delta Bay”, me subjekt investues aplikues “XH&M shpk”, NUIS/NIPT: J91825009L në procedurën “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar”.
2. Subjekti propozues duhet të paraqesë garanci financiare shtesë për realizimin e projektit të synuar pasi dokumentacioni i dorëzuar nuk përmbush kriterin e garancisë financiare.
3. Të pritët Vendimi i KKT mbi kërkesën për aplikim Nr. 916 Prot, datë 11.04.2017 të subjektit për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Delta Bay Resort-Kompleks turistik, vila dhe hoteleri 2 kat në plazhin e Dhraleos, fshati Palasë, Bashkia Himarë”.
4. Vendimi i KIS publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet me shkrim kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

SENIDA MESI